



## PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka caktuar datën 4 nëntor 2022 si datë për mbajtjen e konferencës së radhës mbi ecurinë e çështjes, në orën 13:30 min.

Në urdhrin për caktimin e datës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake njoftoi se gjatë konferencës për ecurinë e çështjes ai do të kërkojë nga Mbrojtja dhe Prokuroria që të bëjnë të ditur nëse parashikojnë të hasin vështirësi lidhur me kalimin e lëndës Trupit Gjykues deri në fund të vitit.

Ai më tej do të kërkojë informacion të përditësuar nga Prokuroria për procesin e nxjerrjes së materialeve dhe nëse parashikohet të hasen vështirësi në dorëzimin të listës së 40 dëshmitarëve të parë që Prokuroria synon të thërrasë për të dëshmuar në gjykim deri më 18 nëntor.

Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake njoftoi se ai do të presë të marrë informacion të përditësuar nga Mbrojtja për ecurinë e hetimeve të saj. Lidhur me kundërshtimet që Mbrojtja mund të ketë për ndonjë nga provat e nxjerra, Gjykatësi u interesua të dijë nëse ata parashikojnë të hasin vështirësi në lidhje dorëzimin deri më 18 nëntor të njoftimeve përkatëse.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Zyra Administrative dorëzoi më 14 tetor raportin e saj të tetë mbi pjesëmarrjen e viktimeve. Në raport, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimeve rekomandon që 39 nga 45 parashtruesit e kërkesave të pranohen si viktima pjesëmarrëse në proces. Sipas mendimit të Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimeve, krimet





që parashtruesit e ankesave pretendojnë se kanë pësuar përkujnë me vendet dhe kohët e përmendura në Aktakuzë.

Viktimat flasin gjuhën shqipe dhe/ose serbe dhe banojnë në shtete të ndryshme. Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave ka vlerësuar se të gjitha viktimat kanë pësuar krime të ngjashme me ato që pretendohet se janë kryer nga të njëjtët kryes. Rrjedhimisht, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave rekomandoi që në grupin ekzistues prej 32 viktimash pjesëmarrëse në këtë çështjeje gjyqësore, të përfshihen edhe 39 viktima të tjera dhe ato të përfaqësohen nga i njëjti Mbrojtës Viktimash.

Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave gjithashtu konstatoi se, ngjashëm si në rastin e grupit ekzistues të viktimave pjesëmarrëse, të 39 parashtruesit e kërkesave për praninë si viktima pjesëmarrëse në proces duhet të konsiderohen si veçanërisht të cenueshëm, pasi të gjithë vijnë në vuajtje trauma dhe shprehin frikë dhe shqetësim për sigurinë e tyre ose të familjeve të tyre, nëse identiteti i tyre bëhet i njohur. Për rrjedhojë, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave rekomandon që identitetet e tyre të mbahen konfidenciale.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të vendosë në lidhje me kërkesat e viktimave si dhe mbi rekomandimet për mbajtjen konfidenciale të identiteteve të tyre.

Duke pasur parasysh raportimet e mediave për DHS-në gjatë javës së kaluar, dëshirojmë të sqarojmë se z. Hashim Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi u arrestuan në nëntor 2020 në bazë të një aktakuze që u konfirmua nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake *para* arrestimit të tyre mbi bazën e fletarrestimeve të lëshuara për ta.

Në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës, Trupi Gjykses mbajti konferenca përgatitore për gjykimin më 18, 19 dhe 20 tetor. Gjatë këtyre konferencave, Trupi Gjykses dëgjoi parashtrimet e palëve dhe të mbrojtësit të viktimave, ndër të tjera lidhur me listat e





dëshmitarëve dhe provave, viktimat që janë gjithashtu dëshmitarë, procesin e zhdëmtimit dhe trajtimin e informacionit konfidencial. Prokuroria, Mbrojtja dhe mbrojtësi i viktimave u ftuan të shprehin me shkrim mendimet e tyre në lidhje me këto aspekte. Trupi Gjykes bëri të ditur se së shpejti do të marrë vendim në lidhje me aspektet që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e viktimave, zhvillimin e procesit gjyqësor dhe do të caktojë datën e fillimit të procesit gjyqësor.

Ndër lajme të tjera përmendim se këtë javë Dhomat e Specializuara të Kosovës pritën organizata joqeveritare nga Kosova dhe Serbia për një seminar dyditor në lidhje me programin për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHS-së. Në qendër të vëmendjes së këtij seminari ishte trajtimi i perceptimeve për DHS-në dhe marrja e mendimeve dhe rekomandimeve lidhur me mënyrën se si gjykata mund të informojë sa më shumë njerëz duke dhënë informacion të saktë që u jep përgjigje pyetjeve që mund të kenë qytetarët e Kosovës për fazën aktuale të procesit.

Kryetarja Ekaterina Trendafilova dhe Administratorja Fidelma Donlon u uruan mirëseardhjen pjesëmarrësve dhe folën për rëndësinë që gjykata i kushton gjetjes së mënyrave të reja për ta sjellë drejtësinë më afër njerëzve.

### **Pyetjet e gazetarëve**

Nuk u bënë pyetje

